



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1104/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Alternativa dega në Gjakovë, paraqitur kundër Teuta Pallaska Milla nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Gjakovë, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më datë 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa ZL.Anr.1104/2017, e datës 20.11.2017 e parashtruar nga subjekti politik Alternativa dega në Gjakovë, paraqitur kundër Teuta Pallaska Milla nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Gjakovë.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 20.11.2017 ka pranuar ankesën ZL.Anr.1104/2017 të dorëzuar, nga subjekti politik Alternativa dega në Gjakovë në të cilën pretendon se në venvotimin 0202X/11R Teuta Milla asambleiste e zgjedhur nga subjekti politik AAK nga krye komisionerja e AAK-së Agnesa Meqa është lejuar të votoj edhe pse llampa ultravjollve ka sinjalizuar. Parashtruesi i ankesës dyshon se e njëjta ka votuar me kusht në vendvotimin e dyfishtë në shkollën Yll Morina dhe në klasën e rregullt.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk i ka argumentuar me prova pretendimet e tij në ankesë. Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
ZL.Anr.1104/2017 më datën 21.11.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Hasan Shala

***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*